


RAPORT

MUJOR

për të drejtat e njeriut
në Republikën e Maqedonisë së Veriut



maj
2020

PËRMBAJTJA

KONTEKSTI POLITIKO-SHOQËROR	3
TË DREJTAT E PUNËTORËVE	4
• Aktgjykim pozitiv për një grua punëtore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme;	
DISKRIMINIMI	6
• Përmbajtje diskriminuese në Dekretin për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsimin e mesëm gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme;	
GRATË PUNËTORE NË INDUSTRIJËN E TEKSTILIT	7
• Shumë gra punëtore në industrinë e tekstilit të një punëtore të njëjtë tekstili në Shtip janë pozitivë me COVID-19;	
BARAZIA GJINORE	8
• Dështuan institucionet parësore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje;	
• Dialogje feministe;	
PERSONAT ME PENGESA (AFTËSI TË KUFIZUARA)	10
• Asistentët arsimorë;	
• Aktivitete online për mbështetje në kushte shtëpiake;	
GJUHA E URREJTJES	12
• Gjuha e urrejtjes në kohën e pandemisë;	
RAST GJYQËSOR	14
• Këshilli gjyqësor ka konstatuar ushtrim joprofesional dhe i pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit nga ana e një gjyqtari në pension.	

KONTEKSTI POLITIKO-SHOQËROR

Në kontekstin e përhapjes globale të virusit COVID-19 dhe për ballafaqimin e suksesshëm me pandeminë në vend, Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, dy herë gjatë muajit maj e vazhdoi gjendjen e jashtëzakonshme në vend.

Në deklaratën e 15 majit 2020, si arsyetim **për vazhdimin e gjendjes së jashtëzakonshme**, theksohet se: „Arsyeja e këtij vendimi është nevoja për të zbatuar masa ekonomike dhe sociale për t'i zbutur efektet e pandemisë, të cilat tashmë po ndjehen si rezultat i faktit se një numër i madh ndër-marrjesh nuk kanë punuar dhe ende nuk po punojnë. Në fund të muajit, jam njoftuar se pritet të lidhim një marrëveshje kredie me BERZH-in, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për një shumë rreth 160 milion euro. Kuptohet se, gjithashtu, një arsye shumë e rëndësishme, ndoshta arsyeja më e rëndësishme për këtë vendim ishte që në këtë mënyrë Qeverisë t'i lejohet të vazhdojë që përmes dekreteve me forcë ligjore të mundësojë që i gjithë sektori i shëndetësisë të ballafaqohet më suksesshëm me pandeminë.“

Që nga fillimi i krizës në mars 2020, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i ka **monitoruar** rregullisht masat e Qeverisë, veçanërisht në kontekstin e respektimit të të drejtave themelore në kuadër të **Kapitullit 23** - Gjykata dhe të Drejtat Themelore. Duke i marrë parasysh zhvillimet e mësipërme dhe duke e monitoruar zhvillimin e ngjarjeve, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në **raportin** e tij për muajin maj veçanërisht jep një përmbledhje për zbatimin e masave dhe ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë te qytetarët. Ngjashëm me muajt e kaluar dhe në përputhje me trendin e konstatuar, duhet t'i kushtohet vëmendje ballafaqimit me

krizën socio-ekonomike si rezultat i pandemisë – mbrojtjes së komuniteteve të **margjinalizuara**, zbatimit të duhur të masave mbrojtëse, mbikëqyrjes dhe zbatimit përkatës së tyre. Ajo që e shënoi këtë muaj ishte rritja e sërishme e **gjuhës së urrejtjes** në mediat sociale, që është një rezultat i drejtpërdrejtë i relaksimit të masave mbrojtëse dhe heqjes së orës policore, **mosrespektimi i masave** qeveritare nga disa **udhëheqës fetarë** dhe rritje e numrit të personave me COVID -19 në fund të muajit. Në fushën politike dominonte debati për mbajtjen e **zgjedhjeve të parakohshme parlamentare**. Partitë politike nuk ranë dakord për datën e mbajtjes së zgjedhjeve, duke ofruar interpretime të ndryshme për mundësinë e realizimit të tyre.

Më 30 maj 2020, **Presidenti** i shtetit edhe njëherë e zgjati **gjendjen e jashtëzakonshme** në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke sqaruar se „...opinionin tashmë është njoftuar se numri i rasteve të reja me COVID-19, për fat të keq edhe numri i bashkëqytetarëve tanë të vdekur filloi të rritet në ditët e fundit. Është e vërtetë që në shumicën e komunave situata është stabile, por për disa komuna ekziston shqetësim serioz.“ Më në fund, Presidenti u bëri thirrje „udhëheqësve politikë që marrin pjesë në të ashtuquajturat takime të liderëve - shteti nuk ka parlament, ekziston një qeveri teknike që ka autorizime të kufizuara, situata është shumë serioze. Kjo është arsyeja pse unë kërkoj nga të gjithë ata që të jenë në kulmin e përgjegjësisë së tyre historike dhe të bien dakord për datën e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, në mënyrë që të fitojmë institucione me kapacitet të plotë dhe legjitimitet politik. Shteti thjesht nuk mund dhe nuk duhet të funksionojë me muaj vetëm nëse është deklaruar një gjendje e jashtëzakonshme.“



TË DREJTAT E PUNËTORËVE

AKTGJYKIM POZITIV PËR NJË GRUA PUNËTORE GJATË KOHËS SË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME

1 Shkelje e të drejtave të punëtorëve

Këtë muaj, në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut janë **denoncuar 20 raste** të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve ku janë përfshirë **218 punëtorë**. Për dallim nga fillimi i gjendjes së krizës, kur Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka regjistruar **60 raste në mars dhe 85 raste në prill**, kjo paraqet një **ulje** e konsiderueshme pas një periudhe më të gjatë. Megjithatë, si në muajin e kaluar, në muajin maj kemi regjistruar **pushime** të paligjshme nga puna, **paga të reduktuara dhe/ose të papaguara dhe ndërprerje të detyruara të kontratave të punësimit** me marrëveshje. Prandaj, për katër raste kemi parashtruar kërkesa për kryerjen e një **mbikëqyrjeje të jashtëzakonshme inspektuese** pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës. Një kërkesë është parashtruar **për uljen e pagës** të një grupi punëtorësh të sëmure kronik, të cilët janë pushuar nga detyrat e punës, dy kërkesa janë parashtruar për shkak të mo-

spagimit të pagave për mbi 200 punëtorë gjatë kohës së gjendjes së krizës dhe kërkesa e fundit i referohet **pushimit të paligjshëm nga puna e një gruaje punëtoresh shtatzënë**.

REKOMANDIM:

Përveç këshillimit të punëtorëve që t'i përdorin vetë mekanizmat mbrojtës në rast të **shkeljes** së të drejtave të tyre, ne u kemi rekomanduar që të mos nënshkruajnë marrëveshje për ndërprerjen e kontratave të tyre të punësimit. Punëtorët që tashmë kanë nënshkruar kontrata punësimi për kohë të pacaktuar, i këshillojmë të mos nënshkruajnë kontrata punësimi për kohë të caktuar, kurse në shumë raste i kemi sqaruar edhe masat e miratuara nga ana e Qeverisë në lidhje me kategori të ndryshme të punëtorëve dhe grave punëtoresh.

2 Masat ekonomike të Qeverisë

Muaji filloi me **përfaqësimin e suksesshëm të tërheqjes** së Dekretit të Qeverisë me të cilën ndërmarrjeve që përdorin **ndihmë financiare nga shteti** për pagimin e pagave u lejohej të pushojnë nga puna deri në 15% të punonjësve të tyre. Sipas formulimit aktual të Dekretit, **përcaktohet që punëdhënësi** që do ta përdorë ndihmën financiare për pagimin e pagave, **nuk guxon të ketë numër të zvogëluar të të punësuarve** në muajt prill dhe maj të vitit 2020, si dhe dy muaj më pas, deri në korrik të vitit 2020.

Nga ana tjetër, gjatë prezantimit të **paketës së tretë ekonomike**, Qeveria e prezantoi masën „Kompensim me para për të gjithë personat që kanë ngelur pa punë nga 11 mars deri më 30 prill 2020”, si harmonizim me kërkesat e **sindikave dhe organizatave të shoqërisë civile**. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, së bashku me disa organizata të shoqërisë civile dhe sindikatat, që nga fillimi i krizës shëndetësore ka folur për abuzimet e shumta të ndërprerjeve të kontratave të punësimit me „marrëveshje” dhe deklarata të punëtorëve të marra me detyrim, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Si rezultat i kësaj, shumë punëtorë dhe familjet e tyre kanë mbetur pa asnjë të ardhur

dhe nuk kanë mundësi për punësim të ri gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Me këtë **masë**, të gjithë personat që e kanë humbur vendin e punës, përfshirë edhe ata që e kanë ndërprerë marrëdhënien e punës përmes një deklarate me shkrim me marrëveshje ose janë pushuar nga punëdhënësi, do të marrin **kompensim me para** nga Agjencia e Punësimit dhe kjo padyshim është një fillim i mbarë. Me këtë kompensim përfshihen të paktën 8.000 punëtorë, ekzistenca e të cilëve u rrezikua seriozisht për arsye se ata mbetën pa bazën e vetme mbi të cilën i realizojnë të ardhurat për jetesën.


Sidoqoftë, **Qeveria nuk e respektoi marrëveshjen** e arritur në mbledhjen e 30 prillit, kur u bë marrëveshja që këta persona të përfshihen në **zgjidhjen sistimore për sigurim** në rast të **papunësisë**, respektivisht të marrin **kompensim** për një periudhë kohe që varet nga kohëzgjatja e përvojës së punës, dhe jo vetëm për 2 muaj.

Fakti që **Qeveria** nuk e mbajti fjalën e saj dhe e tërhoqi vendimin fillestar tregoi se sa i respekton punëtorët, gratë punëtore dhe sindikatat, si përfaqësues të tyre. Në periudhën e ardhshme, **pritet** që Qeveria ta harmonizojë edhe këtë **masë** me logjikën që qëndron në **Ligjin për punësim dhe sigurim në rast papunësie** dhe ta harmonizojë periudhën e sigurimit me kohëzgjatjen e përvojës së punës, në vend të një afati të përcaktuar aty për aty për dy muaj, për të gjithë punëtorët, pavarësisht përvojës së tyre të punës.

3 Praktika gjyqësore

Në fillim të vitit 2019, një punonjëse e punësuar në një institucion shëndetësor iu drejtua Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut me një kërkesë për **ndihmë juridike falas**. Ajo na informoi se punëdhënësi ka filluar procedurë disiplinore ndaj saj për gjoja mosrespektim të urdhrave me gojë të dhëna nga eprorja e saj, respektivisht për **shkelje të rendit dhe disiplinës së punës** për arsye se ajo nuk ka pranuar t'i kryejë detyrat e saj të punës. Procedura disiplinore ka konstatuar përgjegjësi tek punonjësja dhe ndaj saj është shqiptuar masë disiplinore në formën e gjobës në para në shumë prej 15% të pagës së paguar të fundit, për një periudhë prej dy muajsh. Punonjësja pohoi se procedura është zbatuar në mënyrë tendencioze pa praninë e saj dhe se dëshmitarët e ngjarjes nuk janë dëgjuar fare, dhe vendimi me të cilin është shqiptuar masa disiplinore ndaj saj nuk përmban asnjë arsyezim. Vendimi nuk ka specifikuar se çfarë urdhri me gojë ka marrë punonjësja dhe konkretisht cilat detyra të punës ajo ka refuzuar t'i kryejë. Prandaj, ajo ka apeluar me ankesë ndaj vendimit, por ankesa i është refuzuar.

Me ndihmën dhe mbështetjen e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, përmes një avokati me të cilin organizata jonë ka themeluar bashkëpunim, punonjësja inicoi një **kontest gjyqësor kundër vendimeve të tilla para Gjykatës Themelore Civile Shkup**. Këtë muaj, Gjykata i dorëzoi një aktvendim punonjësës me të cilën ajo e pranoi padinë e saj, dhe i anuloi si të paligjshme dy vendimet e marra nga institucioni shëndetësor dhe Bordi Drejtues i institucionit shëndetësor.



DISKRIMINIMI

PËRMBAJTJE DISKRIMINUESE NË DEKRETIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E DEKRETIT ME FUQI LIGJORE PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR ARSIM TË MESËM GJATË KOHËS SË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME

Me Dekretin për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e **Ligjit për arsim të mesëm** gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme (Gazeta zyrtare nr. 116/2020 të datës 05.05.2020) lirohen nga provimi i maturës shtetërore, maturës shkollore, provimit përfundimtar me afat vlefshmërie prej 3 vjet dhe provim të dhënë me afat vlefshmërie prej katër vjet në arsimin e mesëm gjimnazist, arsimin e mesëm profesional, arsimin e mesëm të artit dhe arsimin e mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, nxënësit nga vitet përfundimtare të arsimit në vitin shkollor 2019/2020. Këtyre nxënësve shkollat u japin diploma për kryerjen e arsimit të mesëm.

Nga ana tjetër, me të njëjtin Dekret parashikohet që nxënësit të cilët në vitet e mëparshme shkollore i kanë kaluar provimet e maturës shkollore ose provimet e kryera me afat vlefshmërie prej katër vjet dhe kanë apli-

kuar për provimin e maturës shtetërore në vitin shkollor 2019/2020, nuk janë të liruar nga provimi i maturës shtetërore dhe për të njëjtën është organizuar mbajtja e provimeve për maturë shtetërore. Nxënësit që në vitet e mëparshme shkollore kanë filluar me provimet e maturës shtetërore, maturës shkollore, provimin përfundimtar me kohëzgjatje trevjeçare ose provimin përfundimtar me kohëzgjatje katërvjeçare, nuk i kanë kaluar dhe kanë aplikuar sërish për provim në vitin shkollor 2019/2020, për të njëjtat do të organizohet mbajtja e provimeve për maturën shtetërore, maturën shkollore, provimin përfundimtar me kohëzgjatje trevjeçare ose provimin përfundimtar me kohëzgjatje katërvjeçare.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut reagoi në lidhje me këtë dispozitë kontestuese të Dekretit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

● KONKLUZION:

Kjo dispozitë e Dekretit për ndryshimin dhe plotësimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për arsimin e mesëm gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, paraqet një trajtim të pabarabartë të të dy grupeve të përmendura të nxënësve.

● REKOMANDIM:

Ne i bëjmë thirrje Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të bëjë ndryshim dhe plotësim të këtij Dekreti dhe t'i lirojë ata nga dhënia e provimit të maturës shtetërore, maturës shkollore, provimit përfundimtar me kohëzgjatje trevjeçare dhe provimit përfundimtar me kohëzgjatje katërvjeçare në arsimin e mesëm gjimnazist, arsimin e mesëm profesional, arsimin e mesëm të artit dhe arsimin e mesëm për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore për të gjithë nxënësit në vitet e fundit të arsimit.

GRATË PUNËTORE NË INDUSTRIJË E TEKSTILIT

SHUMË GRA PUNËTORE NË INDUSTRIJË E TEKSTILIT TË SË NJË-JTËS PUNËTORI TEKSTILI NË SH TIP JANË POZITIVË ME COVID-19

Në muajin maj, së bashku me organizatën partnere Glasen Tekstilec, ne dokumentuam një rast të disa grave punëtore në industrinë e tekstilit të infektuara me COVID-19. Në fakt, në një punëtorin tekstil në Shtip në muajin maj janë **regjistruar** 10 gra punëtore pozitive me COVID-19 në industrinë e tekstilit.

Nga bisedat që i kishin asistentet e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut me gratë punëtore nga kjo punëtori, morëm informacion se në uzinën për prodhimin e konfeksionit është **siguruar distanca e përcaktuar** ndërmjet punëtoreve gjatë kryerjes së detyrave të punës dhe se ambienti **dezinfektohet rregullisht**. Kjo është konfirmuar edhe pas një **mbikëqyrje të jashtëzakonshme** inspektuese nga ana e Inspektoratit Shtetëror të Punës, me çrast është konstatuar se **nuk ekzistojnë shkelje të respektimit të masave**.

Nga ana tjetër, sipas informacioneve tona të marra nga punonjëset e punëtorisë, nuk janë **respektuar masat për transportimin** e punonjëseve deri në punëtori dhe gjatë transportit nuk është **siguruar distanca e kërkuar** midis punonjëseve. Përkatesisht, disa nga **punonjëset e infektuara** jetojnë në fshatrat afër Shtipit dhe ndërrojnë dy mjete transporti deri në vendin e punës, së pari, nga vendi i vendbanimit për në Shtip udhëtojnë me furgon, dhe më pas në stacionin e autobusëve në Shtip transferohen në autobusë që transportojnë punonjëse të disa punëtorive dhe kështu transferohen në vendin e punës. Në asnjërin nga të dy transportet nuk janë **respektuar rekomandimet për mbajtjen e distancës** ndërmjet punonjëseve, sepse në të dy transportet **kanë udhëtuar më shumë punonjëse se sa lejon kapaciteti i përshkruar**.

Lidhur me respektimin e masave nga ana e punonjëseve, kemi informacione që numër i madh i punonjëseve në autobusë dhe në vendin e punës, jo gjithmonë kanë mbajtur maska dhe/ose maskat i kanë përdorur në mënyrë jo korrekte.

Edhe pse deri më tani janë regjistruar 10 punonjëse të infektuara nga kjo punëtori, shqetëson fakti që ka më shumë punonjëse me simptoma të COVID-19 dhe ato do të testohen në mënyrë shtesë. Poashtu shqetësues është fakti që anëtarët e ngushtë të familjeve të punonjëseve të infektuara, të cilët gjithashtu janë pozitivë me COVID-19, punojnë në punëtori

të tjera të tekstilit në Shtip, gjë që e rrit edhe më shumë **rrezikun e përhapjes së virusit** në mesin e punonjëseve të tekstilit në Shtip.


Pas testeve pozitive të punonjëseve të para të testuar në punëtorinë e tekstilit, punëdhënësi përkohësisht e ka mbyllur punëtorinë e tekstilit.

KONKLUZION:


Mbetet konstatimi se punonjësit dhe punëdhënësit nuk i respektojnë dhe zbatojnë plotësisht masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 në vendet e punës. Punëdhënësit dhe transportuesit nuk e kanë respektuar Dekretin me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për Transport Rrugor gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, sipas të cilit gjatë transportit publik të udhëtarëve, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, transportuesi është i detyruar ta organizojë transportin duke e mbajtur distancën e detyrueshme prej të paktën dy metrave ndërmjet udhëtarëve dhe që të guxojë të ketë maksimalisht deri në 50% të udhëtarëve nga numri i përgjithshëm i ulëseve, duke mos e llogaritur ulësen e shoferit.

REKOMANDIM:

Ju bëjmë thirrje punëdhënëseve dhe punëtorëve që plotësisht dhe në mënyrë të vazhdueshme t'i respektojnë masat mbrojtëse dhe parandaluese kundër COVID-19 gjatë punës, në drejtim të mbajtjes së maskave mbrojtëse në mënyrë korrekte, mbajtjes së distancës gjatë kryerjes së procesit të punës dhe dezinfektimit të procesit të punës. Punëdhënësit dhe transportuesit ta organizojnë transportin e punëtorëve deri tek vendet e punës në përputhje me Dekretin me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për transport rrugor gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. U bëjmë thirrje të gjitha grave punonjëse në industrinë e tekstilit, të cilat konsiderojnë se punëdhënësit e tyre nuk i respektojnë masat mbrojtëse dhe parandaluese kundër COVID-19 me rastin e transportit në vendet e punës dhe/ose gjatë procesit të punës, atë ta denoncojnë në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ose në Glasen Tekstilec. Ne i bëjmë thirrje Ministrisë për Punë të Brendshme që të kryejë kontrole të intensifikuara mbi transportuesit që kryejnë transport të punonjëseve të tekstilit në vendet e punës.



BARAZIA GJINORE



DËSHTUAN INSTITUCIONET PARËSORE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE

Që nga muaji mars i këtij viti, me fillimin e gjendjes së krizës me virusin korona, kur u shpall për herë të parë **gjendja e jashtëzakonshme** në territorin e vendit tonë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut e **ngriti alarmin se numri i rasteve të dhunës në familje** ka gjasa të rritet ndjeshëm. Si më parë, ashtu edhe gjatë kohës së kësaj gjendjeje, puna e **institucioneve kompetente** që janë të detyruara të marrin masa për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave është duke u **monitoruar nga afër**.

Qendra për Punë Sociale është njëra nga institucionet që e përfaqëson **mekanizmin parësor mbrojtës** për viktimat e **dhunës në familje**, kurse zyrtarët e punësuar në ato institucione zakonisht janë kontakti i parë i viktimave. Këtë muaj ishin shqetësuese ankesat që arritën nga dy gra viktimat të dhunës në familje, që i referohen Qendrës për Punë Sociale në Kriva Pallankë. Njëri rast i referohej një viktime, të cilës personat zyrtarë **kanë refuzuar t'i ofrojnë ndihmë** dhe mbështetje për shkak të adresës së vendbanimit të saj, e cila ka qenë në një qytet tjetër sipas dokumentit të saj të identifikimit, ashtu që ajo ka qenë e ridrejtuar që rastin ta denoncojë në qytetin tjetër. Në fakt, **të gjitha procedurat lidhur me dhunën në familje në përputhje me ligjin, duhet të jenë urgjente**. Mungesa e urgjencës, ridrejtimi i viktimave nga një institucion, në një tjetër, kontribuojnë në **viktimizimin shtesë të viktimave**, veçanërisht në këtë gjendje krize kur viktimat janë në izolim me dhunuesit dhe rreziku ndaj shëndetit dhe sigurisë së tyre është rritur ndjeshëm. Mbrojtja e viktimave duhet të jetë përparësia kryesore, pavarësisht se cili është vendbanimi i tyre në kartën e identitetit. Kjo, në asnjë rast nuk duhet të jetë një kriter me të cilin institucionet duhet të udhëzohen në veprimet e tyre në situata kaq jashtëzakonisht urgjente.

Rasti i dytë i referohet një gruaje të moshuar me pengesa fizike e cila po përjeton dhunë në familje nga ana e djalit të saj. Edhe pse ajo disa herë e ka **denoncuar dhunën** në Qendrën kompetente për punë sociale në Kriva Pallankë, akoma **nuk e ka marrë mbrojtjen e nevojshme**,

kurse jetesa e saj në një shtëpi të përbashkët me dhunuesin është rrezik i përditshëm për jetën dhe shëndetin e saj. **Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, pas denoncimit të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka kryer një mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese mbi punën e kësaj Qendre, por rezultatet e kësaj mbikëqyrjeje ende janë në pritje**.

Poashtu shqetësuese ishin edhe informacionet që i morëm nga ana e një viktime nga Shkupi, e cila po përjeton dhunë në familje nga ana e djalit të saj. Pas **sulmit të fundit fizik** ndaj saj, ajo është përpjekur ta **denoncojë** rastin në numrin e telefonit 192, por megjithëse është përpjekur disa herë ta merr **policinë, përpjekjet kanë qenë të pasuksesshme**. Me ndihmën e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, viktimat arriti ta denoncojë dhunën përmes numrit të telefonit të stacionit policor, sipas komunës së vendbanimit të saj dhe përmes kontakteve të ekipit kujdestar pranë Qendrës për Punë Sociale.



REKOMANDIM:

Kriza e shkaktuar nga virusi korona vetëm në mënyrë shtesë i ka kristalizuar dhe i ka bërë më të dukshme mangësitë e sistemit për mbrojtje nga dhuna në familje. Këtë periudhë, shteti dhe institucionet u vënë në test në lidhje me masat dhe shërbimet që i ofrojnë për mbrojtjen e kësaj kategorie të brishtë të qytetarëve. Por, edhe pse u miratuan masa, shërbimet tani për tani, në shumë raste u treguan si jofunksionale. Policia dhe qendrat për punë sociale nuk guxojnë mos të jenë në dispozicion për viktimat dhe të jenë pasivë në veprimin e tyre, si në rastet e denoncuar në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

DIALOGJE FEMINISTE

Gjatë muajit maj filloi realizimi i aksionit të ri përmes platformës Meduza, e ashtuquajtur **Meduza Talks**: dialogje feministe për jetën në kohën e krizës dhe pas saj. Qëllimi i këtij aktiviteti është që brenda disa episodeve, nëpërmjet dialogjeve, të adresohen **tema dhe çështje të rëndësishme nga fusha e politikave gjinore, feminizmit, të drejtave të njeriut, grupeve të marginalizuara dhe pabarëzive**, të cilat në një mënyrë dolën në shesh gjatë kësaj periudhe, njëjtë të rëndësishme si çështja e shëndetit publik gjatë kohës së pandemisë. Në episodin e parë „Në shtëpi nuk ka siguri për të gjithë“ për dhunën në familje, dhunën nga partneri/ ja ose të bazuar në gjini gjatë kohës së izolimit shtëpiak, biseduan Sanella Shkrijelj (zëvendëse zëvendëse ministre për punë dhe politikë sociale) dhe Elena Dimushevska (drejtore ekzekutive e Rrjetit kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje). Të dyja bashkëbisedueset treguan se kriza, izolimi shtëpiak, stresi akut dhe humbja e ndjenjës së kontrollit janë faktorë që në mënyrë të konsiderueshme kontribuojnë në rritjen e dhunës në shtëpitë ku ajo tashmë ekziston, por edhe fenomeni i dhunës në familje ku më parë nuk ka pasur

dhunë, por kanë pasur vetëm konflikte. Sipas znj. Dimushevska, është shqetësuese që në periudhën e fundit, me përjashtim të Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale, asnjë institucion kompetent nuk ka marrë masa përkatëse, as edhe dhënie informacioni në lidhje me denoncimet e dhunës. Atë që e përmendi znj. Shkrijelj në drejtim të njëjtë, edhe pse pandemisë me shumë gjasë shumë shpejtë do t'i vijë fundi, pandemia e dhunës në familje do të jetë ende prezente, duke e marrë parasysh faktin se origjina e problemit gjendet në shpërndarjen e pabarabartë të pushtetit në shoqëri, kurse ballafaqimi gjithëpërfshirës me problemin, ka nevojë për pjesëmarrje aktive të të gjitha institucioneve dhe jo vetëm të Ministrisë për punë dhe Politikë Sociale. Të dyja bashkëbisedueset e theksuan rëndësinë e bashkësisë gjatë kësaj periudhe dhe përgjegjësisë qytetare që t'u ndihmohet viktimave të dhunës, me mjete konkrete për veprim nëse dikush është dëshmitar ose ka informacion për dhunë në shtëpi ose dhunë me bazë gjinore.





PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

ASISTENTËT ARSIMORË

Gjatë këtij muaji, në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut një person i angazhuar si asistent arsimor për nxënës me aftësi të kufizuara në Qytetin e Shkupit parashitri një kërkesë për **ndihmë juridike falas**. Pala na informoi se si pjesë e **Programit të punës me dobi për komunën**, disa persona kanë nënshkruar marrëveshje për **ndihmë financiare** pesë-mujore me Komunën, duke filluar nga janari deri në qershor të këtij viti. Për shkak të krizës së shkaktuar nga virusi korona, që ishte edhe arsyeja e mbylljes së shkollave, **Komuna** në mes të këtij muaji i ka njoftuar gojarisht asistentët se **kontratat e tyre anulohen dhe nuk vlejné që nga muaji prill**. Për më tepër, ata janë informuar se fondet e tyre për muajt prill, maj dhe qershor nuk do të paguhën. Asistentët e angazhuar kanë vazhduar të punojnë me nxënësit përmes mënyrave alternative të mbajtjes së orëve mësimore gjatë muajve prill dhe maj, përkundër faktit se mësimdhënia ishte pezulluar për shkak të pandemisë.

Pala në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dorëzoi një kopje të kontratës ku thuhet se cilado palë mund ta prishë kontratën, me kusht ta njoftojë palën tjetër për prishjen e kontratës, më së voni 15 ditë para prishjes së kontratës. Për shkak se Komuna i ka njoftuar gojarisht për prishjen e kontratës në muajin maj personat e angazhuar si asistentë arsimorë, në mënyrë retroaktive nga muaji prill, ajo i ka shkelur dispozitat e kësaj kontrate.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i këshillonte asistentët që të kërkojnë njoftim me shkrim për anulimin e kontratave, kurse mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe kërkesën për kompensim të dëmit t'i kërkojnë nëpërmjet gjyqit.

REKOMANDIM:

Duke marrë parasysh se numri më i madh i asistentëve arsimorë janë të financuar nga programi i UNDP-së dhe vetëm një pjesë e vogël nga buxhetet e komunave, u bëjmë thirrje të gjithë institucioneve kompetente që të veprojnë në drejtim të sigurimit në kohë të resurseve të nevojshme për qëndrueshmërinë e masave për mbështetje që i parashikon Ligji para fillimit të vitit të ri shkollor në lidhje me sigurimin e asistentëve arsimorë, për të cilat Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut që nga fillimi i vitit të kaluar shkollor ka konstatuar mangësi të shumta. Duke e marrë parasysh faktin se asistentët arsimorë janë të rëndësishëm së veçantë për vazhdimin e procesit arsimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duhet të sigurohen mundësi për vazhdimin e angazhimit të tyre në përputhje me situatën e re të krijuar dhe nëse ka nevojë edhe në shtëpitë e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

AKTIVITETE ONLINE PËR MBËSHTETJE NË KUSHTE SHTËPIAKE

Gjatë muajit maj, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka realizuar **një sërë aktivitesh online** dedikuar për personat që kujdesen për **fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara**.

U realizuan **dy trajnime falas online** dedikuar për prindërit, kujdestarët dhe personat e tjerë që kujdesen për fëmijë apo persona me aftësi të kufizuara në temën „**Si ta identifikoni diskriminimin dhe si ta denonconi?**”. Trajnimi u mbajt nga ana e këshilltareve juridikë të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut që punojnë në ofrimin e dhënies së ndihmës juridike falas. Çështjet e diskutuara në trajnime përfshinin informacione për **ndihmën juridike falas**, kushtet dhe mundësitë për shfrytëzimin e tyre, si të identifikohet **diskriminimi** dhe si dhe ku të denoncohet, **të drejta** nga fusha të caktuara të interesit (shëndetësi, mbrojtje sociale, arsim, marrëdhënie pune etj.), si dhe mundësi për parashtrimin e pyetjeve dhe adresim të problemeve konkrete nga ana e vetë pjesëmarrësve.

Në fund të muajit u organizuan edhe dy **punëtori** falas online në temë **“Mbështetje në shtëpi kur shërbimet nuk janë të disponueshme”**, të cilat gjithashtu ishin dedikuar për mbështetjen e prindërve dhe personave të tjerë që kujdesen për fëmijë me aftësi të kufizuara, në kushtet kur disponibiliteti i shërbimeve është i kufizuar. Të dyja punëtoritë përfshinë tema të ndryshme varësisht nga moshë e fëmijëve, duke u fokusuar në mënyra të ndryshme të përshtatjes ndaj situatës së re të krijuar, këshilla praktike për organizimin kreativ të ditës në shtëpi, për stimulimin e zhvillimit kognitiv dhe të motorikës, si dhe mbështetje lidhur me vlerësimin sipas KNF (Klasifikimi ndërkombëtar i funksionimit, pengesave dhe shëndetit) dhe përfshirjen në arsimin e rregullt. Punëtoritë u zhvilluan nga ana e edukatoreve speciale me përvojë shumëvjeçare me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.






GJUHA E URREJTJES



GJUHA E URREJTJES NË KOHËN E PANDEMISË


Ky raport i referohet muajit maj 2020. Ngjashëm me muajt mars dhe prill, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut vazhdoi të **regjistrojë** numër të madh **denoncimesh që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes** në mediat sociale, respektivisht gjithsej 105 denoncime të verifikuara për muajin maj. Numri më i madh i rasteve që ishin regjistruar gjatë muajit prill i referoheshin situatës së pandemisë së virusit COVID-19, zgjatjes së sërishme të gjendjes së jashtëzakonshme dhe masave të Qeverisë për ballafaqim me krizën. Reaksionet në mediat sociale, ngjashëm si në muajin prill 2020, u referoheshin pritjeve për ndërprerjen e orës policore, deklaratave të udhëheqësve fetarë dhe mbajtja e riteve fetare (litia në Strugë, si dhe festa fetare Ramazan Bajram).

Trendi i gjuhës së urrejtjes, maj 2020




Siç mund të konstatohet nga tabela për trendin e gjuhës së urrejtjes në mediat sociale për muajin maj 2020, numri më i madh i denoncimeve janë vërejtur në dy periudha – mbajtja e litisë për Shën Gjergjin në Strugë – përkundër rekomandimeve të Qeverisë për distancë sociale dhe protokolle përkatëse¹ dhe ngjashëm si në muajin prill para festës fetare të Pashkëve, në këtë periudhë u rrit gjuha e urrejtjes para festës së muslimanëve Ramazan Bajram. Edhe përkundër rekomandimeve të qarta të Qeverisë për respektimin e masave për ndalimin e përhapjes së virusit COVID-19, një pjesë e **udhëheqësve fetarë** kanë pasur qëndrime dhe rekomandime të kundërta në atë periudhë dhe e **lejuan mbajtjen e riteve fetare**. Denoncimet e konfirmuara për gjuhë të urrejtjes mund t'i kontrolloni në faqen e internetit www.govornaomraza.mk.

Gjuha e urrejtjes në mediat sociale për muajin maj 2020.




¹ <https://vlada.mk/protokoli-koronavirus?fbclid=IwAR1w6Y8bSmsKrVT-W2Jl9XhweWRFuHK4tOeQcRSC6kGVuDSemS65nYS-hhw>

Numri më i madh i **denoncimeve** (ose 67% të numrit të përgjithshëm të denoncimeve të verifikuara) ngjashëm si në muajt mars dhe prill përsëri i referohen dy kategorive edhe atë **përkatësisë etnike dhe përkatësisë politike**. Siç theksuam më lartë, numri i shtuar përsëri është rezultat i zgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme në vendin tonë për ndalimin e përhapjes së virusit COVID-19. Gjithashtu, është vërejtur diskutim aktiv me konotacion negativ midis përkrahësve të partive në pushtet dhe opozitës, veçanërisht për mënyrën se si shteti po e përballon krizën, posaçërisht diskutimi rreth datës për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.



Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut edhe në këtë raport edhe një herë e shpreh shqetësimin për rritjen drastike të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht në kontekstin e posakrijuar me zgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme në vendin tonë. Kjo është veçanërisht me rëndësi në mungesë të Kuvendit funksional dhe mundësisë për mbikëqyrje efikase mbi punën e pushtetit ekzekutiv gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme. Në pajtim me këtë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut u bën thirrje qytetarëve që ta denoncojnë gjuhën e urrejtjes në mediat sociale, por njëkohësisht edhe në Ministrinë për Punë të Brendshme (Sektori për krim kompjuterik dhe forenzikë dixhitale).



RAST GJYQËSOR

KËSHILLI GJYQËSOR KA KONSTATUAR USHTRIM JOPROFESIONAL DHE TË PANDËRGJEGJSHËM TË FUNKSIONIT TË GJYQTARIT NGA ANA E NJË GJYQTARI NË PENSION

Në Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut me kërkesë për **ndihmë juridike falas** është drejtuar gjyqtarja Snezhana Gerovska Popçevska. Ajo na njoftoi se në vitin 2007 Këshilli gjyqësor i RM-së e ka shkarkuar nga funksioni i gjyqtarit pranë Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup për shkak të **ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit** për lëndën P.nr.2904/01 i njohur në opinion si „Baçillo“. Këtë vendim të Këshillit, znj. Popçevska e ka ankimuar në Këshillin pranë Gjykatës Supreme e cila ankesën e saj e ka refuzuar si të pabazuar dhe e ka konfirmuar vendimin e Këshillit Gjyqësor për shkarkimin e saj nga funksioni i gjyqtares. Për shkak të shkeljeve të bëra në procedurë, znj. Popçevska ka inicuar **procedurë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut**, e cila në janar të vitit 2016 ka miratuar **aktgjykim** në të cilin ka **konstatuar shkelje të nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**. Në fakt, shkelja i referohej mungesës së paanshmërisë dhe pavarësisë së duhur të Këshillit Gjyqësor, për shkak të pjesëmarrjes së Kryetarit të atëhershëm të Gjykatës Supreme dhe Ministrit të atëhershëm të Drejtësisë, në procedurën dhe vendimmarrjen e Këshillit Gjyqësor për shkarkimin e gjyqtares. Në shkurt të vitit 2016, znj. Popçevska e ka fituar të drejtën e pensionit të pleqërisë, kurse në muajin maj të vitit 2016 ka paraqitur Kërkesë për përsëritjen e procedurës mbi bazën e aktgjykimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Dy vite më vonë, në shkurt të vitit 2018 Këshilli Gjyqësor e miratoi kërkesën e saj dhe e lejoi përsëritjen e procedurës së përfunduar të plotfuqishme.

Me vendim të datës 5.6.2019 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka konstatuar ushtrim joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit për gjyqtaren tashmë në pension Snezhana Gerovska Popçevska. Zonja Popçevska e apeloj këtë vendim në Këshillin e Gjykatës Supreme për shkelje thelbësore të procedurës së vendimmarrjes, jokompetencës së Këshillit Gjyqësor për të vendosur në rastin konkret, moskorrig-

jimin e shkeljes së konstatuar me aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zbatim të pasaktë të të drejtës materiale, dhe gjithashtu për shkak të mungesës së elementeve për konstatimin e papërgjegjshësisë dhe joprofesionalizmit në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Zonja Popçevska më tej deklaroi në ankesë se provat e paraqitura aspak nuk ishin vlerësuar - një aktvendim i miratuar nga Këshilli Gjyqësor në vitin 2008 i cili e ndalon procedurën e iniciuar për konstatimin e ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit kundër gjyqtares në gjykatën e apelit, për shkak se gjyqtarja i ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, kurse veprimi i Këshillit është bërë i pavlefshëm.

Këshilli për vendimmarrje ndaj ankesave i formuar pranë Gjykatës Supreme në tetor të vitit 2019 e ka miratuar ankesën e znj. Popçevska dhe e ka shfuqizuar vendimin e Këshillit Gjyqësor. Këshilli ka vendosur se arsyetimi ankimues për shkelje thelbësore të dispozitave në procedurë ka qenë i bazuar, për shkak të faktit se vendimi i ankimuar ka qenë i paqartë dhe i pakuptueshëm dhe nuk ka përmbajtur arsye mjaftueshëm të shpjeguara për faktet vendimtare nga të cilat Këshilli Gjyqësor është udhëzuar në procesin e vendimmarrjes. Këshilli thekson se në arsyetimin e vendimit të ankimuar thuhej se gjatë miratimit të tij Këshilli Gjyqësor ka pasur parasysh se paditësja nuk është gjyqtar aktiv dhe prandaj ajo nuk shkarkohet por vetëm në tekstin e aktvendimit konstatohet ushtrim joprofesional dhe i pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit. Këshilli Gjyqësor ka theksuar se në rastin konkret nuk ekziston mundësi ligjore të miratohet vendim për shkarkimin e gjyqtarit, duke e marrë parasysh faktin se ajo i ka plotësuar kushtet e pensionit të pleqërisë. Për shkak të kësaj, Këshilli Gjyqësor ka vendosur deklarativisht. Por, për Këshillin e Gjykatës Supreme ky arsyetim ka qenë kundërthënës, i paqartë dhe i pakuptueshëm, për shkak se teksti i vendimit nuk ka qenë korrespondues dhe ka qenë kundërthënës me arsyetimin për miratimin e tij, të përmbajtura në arsyetimin.

Për më tepër, Këshilli i Gjykatës Supreme deklaroi se në dispozitat ligjore të cituara, mbi të cilat Këshilli Gjyqësor e ka bazuar vendimin e tij, nuk parashikohet mundësi ligjore për konstatim deklarues të performancës joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit të gjyqtarit, por për ushtrim joprofessional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit është i mundshëm vetëm shkarkimi nga funksioni i gjyqtarit.

Këshilli thekson që ligjvënësi e ka parashikuar mundësinë që Këshilli Gjyqësor të marrë vetëm vendim që e pezullon procedurën dhe vendimin për shkarkimin e gjyqtarit për shkak të ushtrimit joprofessional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, dhe nuk ka parashikuar mundësi për konfirmim vendimi për ushtrim joprofessional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit të karakterit deklarativ, siç ka miratuar Këshilli Gjyqësor në rastin konkret. Për shkak të kësaj, për Këshillin e Gjykatës Supreme ka qenë e paqartë se në bazë të të cilave dispozita ligjore Këshilli Gjyqësor e ka miratuar vendimin e kontestuar për një gjyqtar tashmë në pension i cili nuk mund të shkarkohet, duke pasur parasysh që funksioni i gjyqtarit tashmë është ndërprerë me anë të forcës së ligjit. Për më tepër, Këshilli i Gjykatës Supreme ka konstatuar se Këshilli Gjyqësor nuk ka deklaruar se në bazë të cilit Ligj për Gjykatat dhe Ligj për Këshillin Gjyqësor është udhëhequr gjatë vendimmarrjes, duke e marrë parasysh kohën e inicimit të procedurës dhe miratimin e vendimit për shkarkimin e gjyqtarit, si dhe rregullat e vlefshmërisë kohore të ligjeve. Për shkak të të gjithë kësaj, Këshilli i Gjykatës Supreme ka vendosur që pa i hequr shkeljet thelbësore të përcaktuara, Këshilli Gjyqësor nuk ka qenë në

gjendje ta zbatojë në mënyrë korrekte të drejtën materiale dhe të miratojë vendim të drejtë dhe të bazuar me ligj.

Këshilli Gjyqësor përsëri në shkurt të vitit 2020 ka miratuar vendim ku ka konstatuar ushtrim joprofessional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, me arsyetim identik në lidhje me karakterin deklarativ të vendimit të miratuar edhe përkundër asaj se bëhet fjalë për gjyqtare në pension, në kundërshtim me udhëzimet e dhëna nga Këshilli i Gjykatës Supreme. Për më tepër, Këshilli Gjyqësor në mënyrë kundërthënëse ka shpjeguar se cilat ligje i ka zbatuar gjatë vendimmarrjes, duke theksuar ligj që nuk e ka zbatuar. Në udhëzimet ligjore është theksuar se vendimi është përfundimtar dhe kundër tij nuk ka të drejtë ankimi, në përputhje me nenin 96 paragrafi 4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor.

Duke marrë parasysh që kjo dispozitë e Ligjit është jokushtetuese dhe e shkel të drejtën e saj për një procedurë në shkallë të dytë, znj. Popçevska ka parashtruar një Iniciativë në Gjykatën Kushtetuese për ta vlerësuar kushtetutshmërinë e kësaj dispozite. Në ndërkohë, ajo e ka ankimuar vendimin e miratuar, dhe këtë herë Këshilli Gjyqësor ka vendosur që ankesa e Snezhana Gerovska Popçevska të refuzohet si e papranueshme, për shkak se është konstatuar se ankesa është deklaruar kundër një vendimi të Këshillit Gjyqësor që është përfundimtar dhe kundër të cilit nuk lejohet ankimi.

